

**20070220355**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR INSPEKTIMIN ADMINISTRATIV**

Neni 1

Në Ligjin për inspektim administrativ ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 69/2004) në Kreun VI titulli „DISPOZITA NDËSHKUESE", zëvendësohet me titullin "DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE".

Neni 2

Në nenin 22 paragrafi 1 fjalët: "Me dënim me para në një shumë prej 3000 deri 10 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje", zëvendësohen me fjalët: "Gjobë prej 200 deri në 1000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet".

Në paragrafin 2 fjalët: "Me dënim me para në shumë prej 2000,00 deri 5000,00 denarë do të dënohet për kundërvajtje", zëvendësohet me fjalët: "Gjobë prej 150 deri në 800 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në "Gazetën zyrtare e Republikës së Maqedonisë".